



BULETIN MUJOR

DHJETOR 2024



PËRMBAJTJA

Nënshkruhet marrëveshja për mbrojtjen e fëmijëve në hapësirën digjitale



Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike dhe Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve kanë nënshkruar një marrëveshje për të përmirësuar mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet dhe abuzimet online. Iniciativa përfshin rritjen e ndërgjegjësimit përmes fushatave edukative, zhvillimin e materialeve për përdorim të sigurt të internetit, forcimin e mekanizmave për parandalimin e abuzimeve dhe krijimin e një mjedisi të sigurt digjital për fëmijët dhe të rinjtë. Ky angazhim synon një të ardhme më të sigurt për brezat e rinj në hapësirën digjitale.

Shqipëria në Cyber Coalition 2024 – Stërvitja e NATO-s për Sigurinë Kibernetike

Cyber Coalition është një stërvitje kyçe për testimin e aftësive në reagimin ndaj sulmeve kibernetike dhe koordinimin mes institucioneve.

Shqipëria u bashkua me aleatët e NATO-s në këtë event kompleks, duke kontribuar me ekspertë nga AKSK, AKSHI, SHISH, NJUSK dhe DPPSH. Pjesëmarrësit punuan në Tallin (Estoni) dhe në TECH-SPACE në Tiranë. Ky bashkëpunim ndërinstitucional forcoi mbrojtjen e hapësirës digjitale të Shqipërisë dhe demonstroi angazhimin për përballimin e kërcënimeve kibernetike.

Z. Igli Tafa dhe Znj. Linda Karçanaj falënderuan ekspertët për përkushtimin dhe profesionalizmin.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



[@aks.gov.al](https://www.instagram.com/aks.gov.al)



+355 422 21 039



AKSK Zhvilloi një Takim Ndërgjegjësues për Grupmoshën e Tretë në Qendrën Komunitare “Gonxhe Bojaxhi” në Tiranë.

Në vazhden e angazhimit për ndërgjegjësimin mbi sigurinë kibernetike, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike zhvilloi një trajnim për grupmoshën e tretë në Qendrën Komunitare “Gonxhe Bojaxhi” në Tiranë. Gjatë takimit, pjesëmarrësit u njohën me bazat e sigurisë online dhe mësuuan si të mbroheshin nga mashtrimet në telefon. Aktiviteti u shoqërua me diskutime dhe shembuj praktikë, duke i ndihmuar ata të ndihen më të sigurt në botën digjitale. Ky projekt do të vazhdojë edhe në vitin 2025, duke synuar të promovojë sigurinë kibernetike për çdo grupmoshë dhe kategori shoqërore.

Takimi i Drejtorit të AKSK-së me Delegacionin Kanadez për Forcimin e Sigurisë Kibernetike

Drejtori i Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, z. Igli Tafa, priti një delegacion nga Kanadaja, i udhëhequr nga z. Gregory Bunghardt dhe z. Yves Belliveau. Takimi u fokusua në ndarjen e praktikave më të mira dhe diskutimin e sfidave të sigurisë kibernetike, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Si aleatë të NATO-s dhe anëtarë të Qendrës së Ekselencës për Kërcënime Hibride, Kanadaja dhe Shqipëria vazhdojnë përpjekjet për të mbrojtur hapësirën kibernetike dhe adresuar kërcënimet hibride, duke rikonfirmuar rëndësinë e partneritetit strategjik mes dy vendeve.



AKSK Organizon Trajnimin “Higjiena Kibernetike” në Bashkëpunim me CRDF Global dhe Departamentin Amerikan të Shtetit

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike vazhdon angazhimin për forcimin e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin mbi sigurinë kibernetike, duke organizuar aktivitetin Cyber Hygiene në bashkëpunim me CRDF Global dhe Departamentin Amerikan të Shtetit. Aktiviteti mbledhi rreth 681 pjesëmarrës online dhe 20 fizikisht nga sektori publik, privat, shoqëria civile dhe universitetet, duke ofruar një platformë për diskutime mbi kërcënimet dhe zgjidhjet kibernetike. Ky aktivitet tregon përpjekjet e AKSK-së për të promovuar praktikën më të mira të sigurisë digjitale dhe për të mbështetur institucionet në përballimin e sfidave të botës kibernetike.



Festat e Fundvitit – Takim për Vigjilencë të Shtuar me Infrastrukturat Kritike të Informacionit

Në fund të këtij vitit, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike organizoi takime me përfaqësues të Infrastrukturas Kritike të Informacionit për të diskutuar rreziqet kibernetike të mundshme gjatë periudhës festive dhe masat parandaluese. Takimet u përqendruan në promovimin e praktikave më të mira, rritjen e vigjilencës dhe forcimin e bashkëpunimit mes institucioneve për mbrojtjen e infrastrukturave kritike. Siguria kibernetike mbetet prioritet, për të siguruar një fundvit të sigurt dhe pa shqetësime për qytetarët dhe institucionet.

